

**VENDIM**  
**Nr.17, datë 28.4.2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.193, DATË 20.3.2020, TË MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, “PËR DETAJIMIN E AKTIVITETEVE SIPAS NOMENKLATURËS SË AKTIVITETEVE EKONOMIKE”**

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, të ndryshuar, Komiteti Ndërmintoror i Emergjencave Civile, në zbatim të masave të marra pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore, i mbledhur sot më 28.4.2020,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së aktiviteteve të lejuara, sipas urdhrit nr.193, datë 20.3.2020, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për detajimin e aktiviteteve sipas nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike”, të ndryshuar, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINTOROR  
TË EMERGJENCAVE CIVILE  
KRYEMINISTËR  
Edi Rama**

**Lista e aktiviteteve të lejuara:**

|         |      |   |
|---------|------|---|
| Lejohen | 4719 | Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara   |
| Lejohen | 4771 | Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara   |
| Lejohen | 4778 | Shitje me pakicë të mallrave të tjera të reja në dyqane të specializuara (Përfshirë dhe Tregtia me pakicë e Armëve dhe Municioneve, Artikujve Ushtarakë). |
| Lejohen | 4932 | Aktiviteti i taksive  |
| Lejohen | 4751 | Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara   |
| Lejohen | 4772 | Tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve prej lëkure në dyqane të specializuara   |
| Lejohen | 9609 | Aktivitete të tjera p.k.t   |
| Lejohen | 4759 | Tregtia me pakicë e mobiljeve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve shtëpiakë në dyqane të specializuara p.k.t  |
| Lejohen | 4776 | Tregtia me pakicë e luleve, bimëve, farave, plehëruesve, kafshëve të shtëpisë dhe ushqimit të tyre në dyqane të specializuara                             |
| Lejohen | 4777 | Tregtia me pakicë e orëve dhe bizhuterive në dyqane të specializuara  |
| Lejohen | 4743 | Tregtia me pakicë e pajisjeve audio dhe video në dyqane të specializuara  |
| Lejohen | 5920 | Regjistrimi i zërit dhe aktivitete të publikimit të muzikës   |
| Lejohen | 4753 | Tregtia me pakicë e qylymave, sixhadeve, veshjeve të mureve dhe dyshemeve në dyqane të specializuara  |
| Lejohen | 4765 | Tregtia me pakicë e lojrave dhe lodrave në dyqane të specializuara  |

|         |      |   |
|---------|------|---|
| Lejohen | 4763 | Tregtia me pakicë e regjistruarve muzikorë dhe video në dyqane të specializuara |
| Lejohen | 4764 | Tregtia me pakicë e pajisjeve sportive në dyqane të specializuara               |
| Lejohen | 4742 | Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikacionit në dyqane të specializuar.  |